



PROJEKT-PROPOZIM

TITULLI I PROJEKTIT	Platforma Rinore për Vendimmarrje
HARTUESIT E PROJEKTIT	Nxënësit e shkollës "Myslym Keta"
VENDI I ZBATIMIT TË PROJEKTIT	Bashkia Tiranë
KOHËZGJATJA E PROJEKTIT	12 muaj
BUXHETI TOTAL	18.000 EURO

ANALIZA E KONTEKSTIT AKTUAL DHE PËRSHKRIMI I GRUPIT TË SYNUARA

Të rinjtë shpesh ndihen të përjashtuar nga proceset vendimmarrëse që prekin drejtpërdrejt jetën dhe të ardhmen e tyre. Ata mendojnë se zëri i tyre nuk merret seriozisht dhe se vendimet merren pa i përfshirë apo pyetur ata. Sipas disa studimeve të kryera në vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë edhe Shqipërinë, një përqindje e konsiderueshme e të rinjve (mbi 60%) shprehën se nuk ndihen të përfaqësuar nga institucionet lokale apo kombëtare. Pavarësisht dëshirës për të kontribuar, mungesa e hapësirave të dedikuara për dialog dhe përfshirje – si këshillat rinorë funksionalë, platformat konsultative apo forume të rregullta me autoritetet – e kufizon ndjeshëm mundësinë e tyre për pjesëmarrje reale.

Shumë të rinj nuk kanë informacion të mjaftueshëm mbi mënyrat se si mund të përfshihen në proceset vendimmarrëse. Sistemet arsimore nuk ofrojnë gjithmonë edukim mbi qytetarinë aktive dhe funksionimin e institucioneve demokratike. Kjo mungesë e edukimit qytetar dhe praktikave të përfshirjes krijon distancë dhe pasivitet. Për më tepër, ata shpesh ndihen të pavlerësuar dhe të padëgjuar, gjë që ndikon negativisht në besimin e tyre ndaj sistemit dhe i largon nga interesimi për çështje publike apo pjesëmarrje në organizata apo struktura rinore.



Barriera të tjera shtesë përfshijnë mungesën e përvojës, burimeve financiare, mentorimit dhe mbështetjes nga të rriturit apo institucionet. Në shumë raste, të rinjtë hasin edhe në qëndrime paragjyquese, ku mendimi i tyre shihet si “i papjekur” apo “idealist”. Në zonat rurale dhe

komunitetet e marginalizuara, këto sfida janë edhe më të theksuara, duke përfshirë mungesën e infrastrukturës për aktivitete rinore, internetit apo mjeteve për komunikim publik.

Për të nxitur përfshirjen aktive të të rinjve, është e nevojshme që institucionet publike të ndërmarrin hapa konkretë për krijimin e hapësirave për dialog, mbështetjen e iniciativave rinore, fuqizimin e këshillave rinorë lokalë dhe integrimin e edukimit qytetar në arsim. Vetëm përmes këtyre mekanizmave mund të rritet ndjesia e përkatësisë, përfshirjes dhe ndikimit tek brezi i ri.

PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti “Platforma Rinore për Vendimmarrje” ka për qëllim të krijojë një urë lidhëse funksionale dhe të qëndrueshme midis të rinjve dhe institucioneve vendore, me qëllim që zëri, mendimet dhe propozimet e tyre të merren në konsideratë në proceset që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën në komunitet. Kjo platformë synon të adresojë boshllëkun ekzistues midis të rinjve dhe autoriteteve publike, duke ofruar një hapësirë të strukturuar për dialog, bashkëpunim dhe ndërveprim të ndërsjellë.

Platforma do të funksionojë në dy nivele: online, përmes një hapësire virtuale ndëraktive dhe fizikisht, përmes pikave të dedikuara brenda shkollave apo qendrave komunitare. Ky kombinim do të garantojë akses më të gjerë dhe gjithëpërfshirës, duke përfshirë si të rinjtë urbanë ashtu edhe ata që jetojnë në zona rurale. Nëpërmjet këtij mekanizmi, të rinjtë do të kenë mundësi të shprehin shqetësimet e tyre, të sugjerojnë iniciativa konkrete dhe të diskutojnë me përfaqësues të institucioneve vendore për çështje që ndikojnë jetën e tyre të përditshme – si transporti publik, mjedisi, siguria në shkollë, aktivitetet kulturore, hapësirat e gjelbra apo zhvillimi ekonomik lokal.

Projekti i jep prioritet angazhimit të nxënësve të shkollave të mesme dhe grupeve të marginalizuara të të rinjve, duke ofruar aktivitete të rregullta si:

- forume rinore dhe sesione dëgjimore me pushtetin vendor;
- trajnime mbi edukimin qytetar dhe pjesëmarrjen demokratike;
- fushata informuese mbi të drejtat dhe mundësitë për përfshirje;
- konkurse apo minigrant për ide qytetare të propozuara nga vetë të rinjtë.



Objektivi kryesor është që kjo platformë të mos mbetet një nismë e përkohshme, por të strukturohet si një instrument i qëndrueshëm që mund të adoptohet nga vetë institucionet lokale në vijim, duke u integruar në politikat dhe planet e zhvillimit vendor.

Për të garantuar një ndikim real, projekti parashikon të ndërtojë partneritete të ngushta me institucionet publike, si pushteti vendor, prefekturat, këshillat bashkiakë si dhe me institucionet arsimore, me qëllim që të rinjtë të kenë një rol të qartë në bashkëvendimmarrje dhe jo vetëm një prani simbolike. Shkollat e mesme do të jenë partnere kyçe në këtë proces, si hapësira ku mund të nisn debatet, iniciativat dhe aktivitetet praktike.

Në mënyrë të veçantë, projekti synon:

- të rrisë kapacitetin e të rinjve për të ndërvepruar në mënyrë konstruktive me institucionet;
- të nxisë ndjenjën e përkatësisë dhe përgjegjësisë qytetare;
- të forcojë besimin reciprok ndërmjet të rinjve dhe autoriteteve vendore;
- dhe të promovojë një kulturë të pjesëmarrjes aktive, duke e trajtuar të rinjtë jo si përfitues pasivë, por si aktorë të barabartë të zhvillimit komunitar.

Në një kontekst ku të rinjtë shpesh ndihen të përjashtuar nga proceset publike “Platforma Rinore për Vendimmarrje” përfaqëson një hap konkret drejt përfshirjes efektive dhe të qëndrueshme, duke e kthyer pjesëmarrjen në një mjet të fuqishëm të ndryshimit social.

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM DHE OBJEKTIVI SPECIFIK

Objektivi i përgjithshëm i projektit është:

Të rrisë nivelin e angazhimit të të rinjve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal dhe komunitar, duke u krijuar atyre hapësira të strukturuar, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për të shprehur mendimet, për të ndikuar në politikat publike dhe për të marrë pjesë aktive në zhvillimin e komunitetit të tyre.

Ky objektivi synon të fuqizojë të rinjtë si aktorë të rëndësishëm të shoqërisë, të rrisë ndërgjegjësimin e tyre mbi rolin që mund dhe duhet të kenë në vendimmarrje, dhe të krijojë ura të reja bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe institucioneve publike, veçanërisht në kontekstin e demokracisë vendore. Gjithashtu, synon të adresojë përjashtimin e të rinjve nga proceset e



vendimmarrjes përmes krijimit të mekanizmave të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, të cilët forcojnë zërin e tyre dhe ndihmojnë në ndërtimin e një marrëdhënieje besimi dhe bashkëpunimi me institucionet lokale dhe shkollat.

Objektivat specifikë të projektit janë:

- Të fuqizojë kapacitetet e të rinjve për të marrë pjesë në mënyrë të informuar dhe aktive në proceset e vendimmarrjes.
- Të krijojë dhe operojë një platformë të qëndrueshme (online dhe fizike) që mundëson pjesëmarrjen e rregullt të të rinjve në diskutime publike dhe dialog me institucionet.
- Të forcojë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve vendore, shkollave dhe të rinjve për një përfaqësim më të mirë të interesave rinore.

Indikatorët kryesorë të matjes së arritjes së objektivit të përgjithshëm

Indikatori - Numri i të rinjve të përfshirë në aktivitetet e projektit

Njësia matëse - Nr. Individësh

Burimet e të dhënave - Lista pjesëmarrësve, formularë regjistrimi

Indikatori - Numri i forumeve, takimeve ose konsultimeve të zhvilluara mes të rinjve dhe institucioneve

Njësia matëse – numër eventesh

Burimet e të dhënave – Raporte aktivitetesh

Indikatori - Numri i propozimeve konkrete të paraqitura nga të rinjtë dhe ndjekja e tyre nga institucionet

Njësia matëse - Nr. propozimesh dhe ndjekje

Burimet e të dhënave - Dokumentacion i dërguar, reagime nga institucionet

Indikatori - Niveli i njohurive të të rinjve mbi të drejtat qytetare dhe proceset vendimmarrëse (para dhe pas)

Njësia matëse - % përmirësim



Indikatori - Pyetësor para dhe pas trajnimeve

Indikatori - Numri i institucioneve lokale dhe shkollave partnere të angazhuara në projekt

Njësia matëse - Nr. partnerësh

Burimet e të dhënave - Marrëveshje bashkëpunimi / raporte zyrtare

Indikatori - Përqindja e të rinjve që raportojnë ndjenjën e përfshirjes dhe ndikimit në vendimarrje

Njësia matëse - % perceptim pozitiv

Burimet e të dhënave - Anketa me të rinjtë

AKTIVITETET

A1: Hartimi i programit të edukimit qytetar për të rinjtë;

A2: Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive me nxënës të shkollave të mesme;

A3: Krijimi dhe administrimi i platformës online për pjesëmarrje rinore;

A4: Pajisja dhe funksionalizimi i hapësirave fizike në shkolla/qendra rinore;

A5: Organizimi i forumeve rinore dhe konsultimeve publike me bashkinë;

A6: Ndërtimi i rrjetit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe të rinjve;

A7: Fushata ndërgjegjësuëse dhe promovuese në komunitet dhe rrjete sociale;

A8: Monitorimi vlerësimi dhe dokumentimi i rezultateve



A1. Hartimi i programit të edukimit qytetar për të rinjtë

- Përgatitja e përmbajtjes mbi pjesëmarrjen qytetare, të drejtat dhe përgjegjësitë e të rinjve, funksionimin e institucioneve publike, vendimmarrjen vendore dhe format e angazhimit aktiv.
- Konsultim me ekspertë të edukimit, organizata rinore dhe mësues për të përshtatur programin sipas moshës dhe nivelit të të rinjve.
- Përkthimi i materialeve në formate të ndryshme (broshura, infografikë, prezantime, video të shkurtra etj.)

A2. Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive me të rinjtë

- Zhvillimi i cikleve të trajnimeve në shkollat partnere dhe qendrat rinore.
- Përfshirja e metodologjive ndërvepruese (role-play, simulime të mbledhjeve të këshillit bashkiak, punë në grupe, diskutime të strukturuar).
- Trajnimi i liderëve të rinj (peer educators) për të vazhduar ndërgjegjësimin edhe pas përfundimit të projektit.

A3. Krijimi dhe administrimi i platformës online për pjesëmarrje rinore

- Konceptimi dhe zhvillimi i një faqeje/platforme digjitale të aksesueshme nëpërmjet celularit dhe pajisjeve të tjera.
- Përfshirja e funksioneve si: publikim temash për diskutim, mbledhje idesh/propozimesh, konsultime online, pyetësorë, njoftime aktivitësh, etj.
- Trajnimi i një ekipi rinor për menaxhimin e përmbajtjes dhe ndërveprimin me përdoruesit.

A4. Pajisja dhe funksionalizimi i hapësirave fizike për pjesëmarrje rinore

- Identifikimi i hapësirave në shkolla apo qendra komunitare që mund të shërbejnë si “Kënd Vendimmarrjeje Rinore”.
- Mobilimi dhe pajisja e hapësirave me materiale edukative, kompjuterë, internet dhe mjete vizuale.



- Vendosja e një kalendari të rregullt për aktivitete fizike në këto hapësira (takime, diskutime, sesione informuese).

A5. Organizimi i forumeve rinore dhe konsultimeve publike me bashkinë dhe institucionet lokale

- Organizimi i forumeve tremujore me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve lokale, këshilltarëve bashkiakë, drejtorëve të shkollave dhe vetë të rinjve.
- Hartimi dhe prezantimi nga të rinjtë i propozimeve konkrete për përmirësimin e jetës në komunitet.
- Ndjekja e reagimeve institucionale dhe nxitja për përfshirje të zërave rinorë në dokumentet dhe politikat vendore.

A6. Ndërtimi i rrjetit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve dhe të rinjve

- Nënshkrimi i marrëveshjeve/memorandumeve të bashkëpunimit me bashkinë, shkollat, drejtoritë arsimore dhe organizatat rinore.
- Krijimi i një bordi këshillimor të projektit me përfaqësim nga të rinjtë dhe institucionet.
- Zhvillimi i takimeve koordinuese dhe reflektuese mbi ecurinë e projektit dhe rolin e secilit aktor.

A7. Fushata ndërgjegjëse dhe promovuese në komunitet

- Krijimi dhe shpërndarja e materialeve promociionale (video, posterë, podcast, postime në rrjete sociale) mbi rëndësinë e pjesëmarrjes rinore.
- Organizimi i aktiviteteve publike (ditë rinore, ekspozita me ide qytetare, panair për pjesëmarrjen) për të rritur vizibilitetin e platformës.
- Përfshirja e mediave lokale për të pasqyruar zërin e të rinjve dhe ndikimin e projektit.

A8. Monitorim, vlerësim dhe dokumentim i rezultateve të projektit

- Zhvillimi i një plani të detajuar monitorimi dhe vlerësimi me indikatorë të matshëm.
- Mbledhja e të dhënave për pjesëmarrje, përmbajtje të platformës, ndikim të aktiviteteve dhe reagim institucional.
- Hartimi i raportit përfundimtar, përfshirë histori suksesi dhe rekomandime për vazhdimësinë e platformës.



REZULTATET E PRITSHME

Rezultati 1: Të rinjtë kanë njohuri më të larta mbi të drejtat qytetare, institucionet dhe proceset vendimmarrëse.

- 300 të rinj të trajnuar në edukim qytetar, pjesëmarrje dhe komunikim me institucione
- 80% e të rinjve të përfshirë raportojnë rritje të njohurive në fund të trajnimeve

Rezultati 2: Një platformë rinore funksionale (fizike & online) është ngritur dhe operon si hapësirë për pjesëmarrje aktive.

- 1 platformë funksionale online me mundësi për diskutime dhe propozime
- 3 hapësira fizike në shkolla ose qendra komunitare që funksionojnë si "kënd vendimmarrjeje"

Rezultati 3: Është vendosur një dialog i rregullt ndërmjet të rinjve dhe institucioneve vendore.

- Të paktën 10 forume konsultative me përfaqësues të bashkisë, shkollave dhe të rinjve
- 15 propozime konkrete të hartuara nga të rinjtë dhe adresuar institucioneve

Rezultati 4: Rrjet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve, shkollave dhe grupeve rinore është krijuar dhe funksionon.

- Të paktën 6 institucione publike dhe 10 shkolla partnere të angazhuara
- Të paktën 1 protokoll bashkëpunimi për vazhdimësinë e platformës pas përfundimit të projektit



Aktiviteti	M 1	M 2	M 3	M 4	M 5	M 6	M 7	M 8	M 9	M 10
A1. Hartimi i programit të edukimit qytetar	✓	✓								
A2. Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive	✓	✓	✓	✓	✓					
A3. Krijimi dhe administrimi i platformës online	✓	✓	✓							✓ (mirëmbajtje)
A4. Pajisja e hapësirave fizike për pjesëmarrje rinore	✓	✓								
A5. Organizimi i forumeve dhe konsultimeve publike				✓	✓	✓	✓	✓		✓
A6. Ndërtimi i rrjetit të bashkëpunimit institucional	✓	✓							✓ (vlerësim)	
A7. Fushata ndërgjegjësuëse dhe promovuese	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓	✓
A8. Monitorim, vlerësim dhe raportim i projektit	✓ (baseline)			✓ (midline)				✓		✓ (final)



Indikatorët kryesorë (në përputhje me objektivat):

Objektivi / Rezultati

Indikatorë

Fuqizimi i të rinjve për pjesëmarrje qytetare

- Nr. të rinjsh të trajnuar
- % rritje në njohuritë e tyre pas trajnimit

Krijimi i platformës për pjesëmarrje

- Platforma online funksionale
- Hapësira fizike aktive në 3 shkolla/qendra

Vendosja e dialogut me institucionet

- Nr. forumeve me pushtetin vendor
- Nr. propozimeve të dorëzuara

Bashkëpunim i qëndrueshëm me institucione dhe shkolla

- Nr. institucioneve/shkollave partnere
- Protokolle bashkëpunimi të nënshkruara



BUXHETI I PROJEKTIT

Aktiviteti	PËRSHRIMI	Buxheti i përafërt (EUR)
A1. Hartimi i programit të edukimit qytetar	Ekspert i angazhuar ne programin e edukimit	1,200.00
A2. Organizimi i trajnimeve dhe punëtorive	Trajnerë për dhënien e trajnimeve	4,500.00
A3. Krijimi dhe administrimi i platformës online	Ekspert IT për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e platformës	3,000.00
A4. Pajisja e hapësirave fizike për pjesëmarrje rinore	mjete të nevojshme për projektin	2,500.00
A5. Organizimi i forumeve dhe konsultimeve publike	Lehtësues për forumet që do të zhvillohen	2,000.00
A6. Ndërtimi i rrjetit të bashkëpunimit institucional	Lehtësues për ndërtimin e rrjetit që do të zhvillohet	1,500.00
A7. Fushata ndërgjegjësuere dhe promovuese	Ekspert PR për projektin	1,800.00
A8. Monitorim, vlerësim dhe raportim i projektit	Ekspert për monitoirm	1,500.00
TOTAL		18,000.00



VIZIBILITETI I PROJEKTIT

Vizibiliteti i projektit “Platforma Rinore për Vendimmarrje” do të sigurohet përmes një strategjie komunikimi dhe promovimi, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi rëndësinë e pjesëmarrjes rinore dhe forcimin e njohjes së vetë projektit në nivel komunitar dhe institucional. Që në fazën fillestare të projektit, do të krijohet një identitet vizual i veçantë – duke përfshirë logon, sloganin dhe materialet grafike që do të përdoren në të gjitha komunikimet zyrtare dhe aktivitetet publike. Platforma online do të shërbejë jo vetëm si mjet pjesëmarrjeje, por edhe si kanal informacioni, ku do të publikohen lajme, njoftime, histori suksesi dhe përditësime të vazhdueshme nga aktivitetet e projektit.

Gjithashtu, rrjetet sociale do të kenë një rol qendror në rritjen e dukshmërisë së projektit tek të rinjtë. Do të krijohen profile të dedikuara në Facebook dhe Instagram, të cilat do të menaxhohen në mënyrë të vazhdueshme për të komunikuar në mënyrë dinamike me komunitetin rinor. Përdorimi i formateve kreative si video të shkurtra, intervista me pjesëmarrësit, grafika dhe postime edukative do të ndihmojnë në përhapjen e mesazhit dhe angazhimin e më shumë të rinjve në platformë. Në të njëjtën kohë, për të zgjeruar audiencën, do të përfshihen edhe media lokale, përmes ftesave në aktivitete, raportimeve në emisione apo intervista me organizatorët dhe pjesëmarrësit.

Element i rëndësishëm i vizibilitetit do të jetë përfshirja e vetë të rinjve në komunikim – ata do të trajtohen për të qenë zëdhënës të platformës në komunitetet e tyre dhe për të promovuar pjesëmarrjen qytetare në mënyrë të barabartë mes bashkëmoshatarëve. Të gjitha materialet promovuese dhe mediatike do të përfshijnë logot dhe elementët e identitetit të donatorit dhe partnerëve, në përputhje me kërkesat përkatëse të brandingut. Në përfundim të projektit do të organizohet një event përmbyllës publik, ku do të prezantohen rezultatet, praktikat e mira dhe do të promovohet vazhdimësia e platformës, duke u dhënë të rinjve një hapësirë të denjë për të treguar kontributin e tyre dhe për të frymëzuar pjesëmarrjen afatgjatë.